


RAPORTI VJETOR 2020



PËRMBAJTJA

1.	Mesazhi i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës	3
2.	Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm	4
3.	Vizioni, misioni, vlerat e Eurosig	6
4.	Qeverisja korporative	7
5.	Eurosig nëpërmjet shifrave	10
6.	Disa të dhëna për Grupin Eurosig	11
7.	Përgjegjësia sociale	12
8.	Promovimi i vlerave të Eurosig, çmime, vlerësime	16
9.	Pjesëmarrjet e Eurosig në kapitalin e shoqërive të tjera	18
10.	Lista e aksionarëve të Eurosig me pjesëmarrje influencuese të kapitalit	18
11.	Lista e administratorëve të Eurosig	18
12.	Raporti i auditimit të brendshëm	19
13.	Monitorimi, administrimi dhe kontrolli i riskut që ndërmerr Eurosig	22
14.	Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, likuiditetit dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike	24
15.	Objektivat për vitin 2021	26



MESAZHI I KRYETARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

*Të nderuar klientë, partnerë, miq e bashkëpunëtorë,
Të nderuar punonjës të Grupit Eurosig,*

Duke përcjellë përzemërsisht urimet më të mira për Ju dhe familjet Tuaja, nëpërmjet këtij mesazhi përshëndetjeje dëshiroj të ndaj me Ju arritjet kryesore të Eurosig gjatë vitit 2020.

Me gjithë situatën e vështirë të krijuar nga pandemia e COVID 19 dhe pasojat e tërmeteve të 2019-ës, në sajë të planifikimeve strategjike dhe një qeverisjeje korporative efektive që zbatuam, shoqëritë e Grupit Eurosig po i kapërcejnë me sukses sfidat e tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe Kosovë, duke treguar qëndrueshmëri, konsolidim dhe standarde të larta.

Rezultatet e arritura në vitin 2020 konfirmojnë se vendimet strategjike të ndërmarra kanë luajtur një rol kyç që Grupi Eurosig të finalizojë me sukses proceset e transformimit. Kjo garanton realizimin me sukses të objektivave strategjike që kemi përcaktuar për të ardhmen në nivel shoqërie dhe grupi.

Standardet e larta të arritura nga Eurosig janë shprehje e bashkëpunimit të suksesshëm që kemi përforcuar në vite me klientët dhe partnerët tanë,

si dhe rezultat i përkushtimit maksimal të Menaxhimit të Lartë, Menaxhimit Operacional dhe të gjithë stafit të Eurosig. Në udhëtimin tonë të përbashkët, kemi treguar se jemi gjithmonë me vizion, kemi identifikuar vazhdimisht mundësi të reja, duke ecur me kërkesat e tregut dhe përshtatur me nevojat e klientëve.

Në emër të Këshillit Mbikëqyrës, dëshiroj të falënderoj të gjithë punonjësit e shoqërive të Grupit Eurosig për punën dhe arritjet në vite, duke u kërkuar që të kenë të njëjtin përkushtim në të ardhmen.

Falënderim i veçantë për arritjet tona u takojnë aksionarëve, klientëve dhe partnerëve të biznesit, për besimin që na kanë dhënë ndër vite.

Me shpresë dhe besimplotë për të ardhmen, Ju ftoj në udhëtimin tonë të përbashkët edhe gjatë vitit 2021.

Vasil PILO

Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës




MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

*Të nderuar klientë, partnerë, miq e
bashkëpunëtorë,
Të nderuar punonjës të Grupit Eurosig,*

Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë për të gjithë njerëzimin, Shqipërinë dhe shqiptarët. Përballja me COVID-19 ishte e gjithanshme, në mënyrë të veçantë, dhe me humbje të bashkëqytetarëve tanë, për të cilën u shprehim ngushëllimet, solidaritetin dhe urimin që ta kemi lënë pas këtë të keqe të madhe, duke shpresuar në Zot për një fillim të ri për shqiptarët, Shqipërinë dhe njerëzimin.

Fillimi i vitit 2020 përkonte me masat dhe përpjekjet e jashtëzakonshme për të vlerësuar dhe shpërblyer dëmet e tërmetit të fundvitit 2019. Shoqëria Eurosig sh.a. mobilizoi jo vetëm burimet njerëzore të saj, por dhe specialistët më të mirë të vendit për të vlerësuar shpejt, drejt dhe në mënyrë ligjore të gjithë të dëmtuarit. Gjatë vitit 2020, ne trajtuam rreth 350 raste të të dëmtuarve



dhe paguam rreth 200 milionë lekë, çka tregon që jemi përpjekur maksimalisht t'u qëndrojmë pranë klientëve tanë, t'i trajtojmë në kohë, me qëllim që t'ua lehtësojmë dhimbjen, së paku atë materiale dhe pasurore.

Edhe për situatën pandemike u morën masa efektive duke filluar nga ato të marketingut, por duke ofruar dhe produkte shëndetësore për klientët dhe qytetarët në tërësi, shërbim online etj. Janë trajtuar rreth 133 klientë vetëm për dëmet e COVID-19.

Gjatë 2020-ës, tregu i sigurimeve të Jo-Jetës u ul me - 5.53%, krahasuar me vitin 2019, duke arritur në 15,4 miliardë lekë. Vlera e dëmeve të paguara u rrit me 24.52%, duke arritur në 6.9 miliardë lekë. Primet vullnetare zënë 31,32% të primeve të sigurimeve të Jo-Jetës.

Shoqëria Eurosig sh.a. arriti një volum primesh mbi 2,035 miliardë lekë. Dëmet arritën në 575 milionë lekë, me një rritje

prej 13% krahasuar me vitin 2019. Pagësa e dëmeve të Fondit të Kompenimit ishte 57 milionë lekë, ose 15,52% të shumës së këtij fondi të paguara nga gjithë tregu.

Treguesit e arritur në këtë vit të vështirë janë rrjedhojë e punës, përkushtimit, profesionalizmit të të gjithë punonjësve, agjentëve, ndërmjetësve, të bashkëpunëtorëve të mi, të cilët me këtë rast i falënderoj për gjithçka kanë bërë gjatë këtij viti për përmbushjen e objektivave strategjike dhe ato vjetore.


Theksoj se këta tregues pozitivë janë realizuar falë dhe kujdesit dhe mbështetjes së Aksionarit kryesor, Z. Kadri Morinaj, dhe Këshillit Mbikëqyrës.

Falënderim i veçantë është për të gjithë ata klientë që na besuan, por dhe për partneret tanë ndërkombëtar, risigurues, brokëra etj., të cilët dëshmuar partneritet, besnikëri dhe besueshmëri ndaj nesh.

Qëllimi i Shoqërisë Eurosig ka qenë dhe mbetet përgjegjshmëria e lartë në shërbimin ndaj klientit. Ofrimi i shërbimeve më të shpejta e cilësore për klientët, duke realizuar procesin e digjitalizimit të shërbimeve, ofrimit online të tyre, dëmshpërblim të drejtë, real dhe të shpejtë; këto do të jenë në themel të punës tonë për të realizuar objektivat e vitit 2021.

Miqësisht,

Dr. Xhevdet KOPANI
Drejtor i Përgjithshëm



VIZIONI, MISIONI, VLERAT E EUROSIG

Vizioni

- Të jemi lider në fushën e sigurimeve, bazuar në standarde europiane, që orientohejmë nga performanca e shtuar, në përputhje me kërkesat e grupeve të interesit, duke u mbështetur në filozofinë e vlerave, profesionalizmit, bazueshmërisë ligjore, reflektimit ndaj kërkesave të klientit dhe fokusimit tek ai.

Misioni

- a) të sigurojmë produkte, shërbime dhe aktivitete ndaj klientëve, nëpërmjet përsosjes së shërbimit, cilësisë, profesionalizmit, etikës, duke funksionuar si një shoqëri financiare, me qëllim optimizimin e kërkesave të klientëve, rritjen e kapitalit financiar, rritjen e vlerës së aksioneve, duke i siguruar klientët për mbështetje në çdo kohë, për kompensim të plotë dhe të drejtë për dëmet e mundshme;
- b) të ofrojmë shërbime sipas standardeve europiane, duke konsoliduar pozicionin dhe duke garantuar emër e reputacion tek partnerët rajonalë, europianë e më gjerë.

Vlerat e shoqërisë

- Shoqëria Eurosig ka një emër në industrinë e sigurimeve dhe përbën një vlerë të shtuar në këtë industri. Përvoja 17 vjeçare në fushën e sigurimeve jo vetëm i ka konsoliduar këto vlera, por i ka bërë të qëndrueshme dhe që ndikojnë drejtëpërdrejt në vlerën e shoqërisë. Filozofia e Eurosigut për orientimin ndaj klientit, përbën një qasje që mbart vlera për tani dhe të ardhmen. Ne kemi krijuar marrëdhënie afatgjata besimi me punonjësit, klientët, grupet e interesit duke u përgjigjur kërkesave të tyre me shpejtësi dhe profesionalizëm. Në Eurosig punohet në grup, nxitet diversiteti, vlerësohen përpjekjet dhe puna orientohet drejt rezultatit.

Vlerë e shtuar e Eurosigut ndër vite është dhe përgjegjësia sociale, falë dhe rolit të spikatur dhe vlerave altruiste të Presidentit të Grupit Eurosig, z. Kadri Morinaj.

Përformimi i shoqërisë në raport me industrinë dhe historinë e saj në treg, rritja, zgjerimi dhe konsolidimi në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, përbëjnë një vlerë që do të ndikojë pozitivisht në performimin e Eurosigut në të ardhmen.

Shtrirja e Eurosigut në të gjithë vendin, burimet njerëzore profesionale dhe me integritet, aftësitë e larta qeverisëse të ekipeve mbikëqyrëse dhe menaxheriale përbëjnë garanci për sukses dhe përballim të sfidave të së ardhmes.

QEVERISJA KORPORATIVE

Qeverisja Korporative e Eurosig

Në Eurosig kemi implementuar modelet më të mira të qeverisjes së biznesit, duke ndarë të drejtat dhe përgjegjësitë ndërmjet aksionarëve, Këshillit Mbikëqyrës dhe Menaxhimit të Lartë. Kjo ka ndikuar pozitivisht në mënyrën e përcaktimit të strategjisë dhe objektivave të Eurosig, përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen e personelit, kryerjen e veprimtarive ditore, përcaktimin dhe respektimin e kodit të etikës dhe sjelljes, duke operuar në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Qeverisja e Eurosig realizohet nga:

Asambleja e Aksionarëve

Z. Kadri MORINAJ	Shoqëria Euro-Alba.Ea shpk	Z. Xhevdet MORINAJ	Z. Ylli MERKAJ
përqindja e pjesëmarrjes	përqindja e pjesëmarrjes	përqindja e pjesëmarrjes	përqindja e pjesëmarrjes
64.505%	17.654%	17.530%	0.311%

Këshilli Mbikëqyrës

Z. Vasil PILO	Z. Rexhep MEIDANI	Z. Jemin GJANA
Kryetar	Anëtar	Anëtar

Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut

Z. Mateo SPAHO	Prof.As.Dr. Zef GJETA	Znj. Brunilda MUJA
Kryetar	Anëtar	Anëtar

Menaxhimi Operacional, i cili menaxhon dhe përgjigjet për performancën e njësive strukturore të Eurosig.

Fushat e përgjegjësisë të organeve mbikëqyrëse, ekzekutive dhe menaxheriale janë të përcaktuara në aktet e brendshme të Eurosig.

Burimet njerëzore

Eurosig, si shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë me 19 degë dhe 10 agjenci¹. Aktualisht në Eurosig janë të punësuar afro 300 punonjës në nivel qendror dhe vendor. Grupi Eurosig performon me sukses dhe në tregun e sigurimeve në Kosovë.

Duke i konsideruar burimet njerëzore si një faktor të rëndësishëm dhe kapitalin intelektual për rritjen e biznesit tonë, Eurosig investon sistematikisht në përzgjedhjen, trajnimin, vlerësimin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e punonjësve.



Klientët e Eurosig

Filozofia e Eurosig është e orientuar ndaj klientëve, duke synuar gjithmonë krijimin e një partneriteti afatgjatë me ta. Stafi i mirëtrajnuar dhe me aftësi të shkëlqyera teknike, por edhe komunikimi, përcjell të njëjtën filozofi biznesi tek klientët.

Ne ofrojmë shërbim të personalizuar për të gjithë klientët, përmes rekomandimeve për llojet e produkteve të sigurimit për të cilat individët ose bizneset mund të kenë nevojë, por edhe përmes krijimit të paketave të kombinuara të sigurimit, në përputhje me eksperiencën më të mirë ndërkombëtare. Produktet tona të sigurimit janë të një standardi ndërkombëtar dhe ofrojnë mbulim në siguri për të gjithë klientët që mund të operojnë në fusha të ndryshme të ekonomisë, tregti apo industri.

¹ <https://eurosig.al/sq/kompania/burimet-njer%C3%ABzore>; <https://eurosig.al/sq/deget-eurosig>.

Partnerët e Eurosig

Detyrimet financiare ndaj klientëve garantohen jo vetëm nga kapacitetet tona teknike dhe financiare, por dhe nga tregu financiar ndërkombëtar. Pjesëmarrësit në kontratat e risigurimit që lidh Eurosig janë shoqëri risigurimi që përmbushin standardet ndërkombëtare të pagesës së dëmeve dhe stabilitetit financiar, të listuara në bazën e vlerësimeve ndërkombëtare, në përputhshmëri dhe në zbatim të kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të Eurosig².

Eurosig bashkëpunon me kompani risigurimi prestigjioze, si Hannover Re, Polish Re, Trust Re, Generali Group, Scor, VIG Re etj. për të garantuar financiarisht detyrimet e mundshme dhe përgjegjësitë ndaj klientëve, si në risqet e sigurimit të pronës ashtu dhe në ato të sigurimeve motorike dhe të përgjegjësiive. Grupi Eurosig ka ruajtur prej disa vitesh dhe ka zgjeruar bashkëpunimin edhe me risigurues të tjerë, si Munich Re, Sava Re dhe Swiss Re.

Me qëllim plotësimin e kushteve teknike sa më të përshtatshme dhe profesionale, shoqëria Eurosig bashkëpunon edhe me brokerët e risigurimit MARSH (brokëri më i madh në botë), AON (brokëri i dytë më i madh në botë), WILLIS, JLT Re etj.



² <https://eurosig.al/sq/partner%C3%ABt>.

EUROSIG NËPËRMJET SHIFRAVE

Gjatë vitit 2020, si kudo, shoqëria Eurosig u ballafaqua me sfida të mëdha për shkak të vështirësive të krijuara nga pandemia e COVID 19. Disa nga treguesit kryesorë të vitit 2020, krahasuar me vitin 2019, janë:

- Volumi i primeve të shkruara bruto është 2 035 704 000 lekë, me një rënie 11.87%.
- Volumi i dëmeve të paguara është 574 901 000 lekë, duke u rritur me 12.93%.
- Pesha specifike e volumit të sigurimeve vullnetare kundrejt totalit është 19%.
- Volumi i primeve të shkruara bruto në Sigurimin Motorik u zvogëlua me 8.15%, Eurosig zotëron 14.96% të tregut.
- Në produktet MTPL e Brendshme zotërojmë 14.64% të tregut, duke u renditur në vendin e tretë.
- Në Sigurimin Kartoni Jeshil zotërojmë 23.99% të tregut, duke u renditur në vendin e dytë.
- Në Sigurimin Kufitare zotërojmë 17.44% të tregut, duke u renditur në vendin e dytë.
- Në Sigurimin Kasko zotërojmë 7.83% të tregut.
- Volumi i primeve të shkruara bruto në Sigurimin e Përgjegjësive Civile u rrit me 45.82%.
- Kemi paguar 57 307 000 lekë nga Fondi i Kompensimit ose 15.52% të totalit të tregut.
- Grupi Eurosig zotëron 20.09% të tregut të sigurimeve të jo-jetës dhe 17.14% të tregut të sigurimeve të jetës në Shqipëri. Kurse në Republikën e Kosovës zotëron 11.31% të tregut të sigurimeve të jo-jetës.
- Në sigurimet motorike Grupi Eurosig renditet në vendin e parë në Shqipëri dhe Kosovë duke zotëruar përkatësisht 23.06% dhe 11.83% të tregut.



DISA TË DHËNA PËR GRUPIN EUROSIG

Organizimi dhe funksionimi i Grupit Eurosig

Sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullatore, Grupi Eurosig funksionon i përbërë nga: shoqëria Eurosig sh.a Shqipëri, shoqëri mëmë; shoqëritë INSIG Jo-jetë sh.a Shqipëri, INSIG Jetë sh.a Shqipëri dhe Eurosig sh.a Kosovë, shoqëri të kontrolluara.

Gjatë vitit 2020, Eurosig rriti pjesëmarrjet e aksioneve pranë bankës UBA në 21% si edhe shtoi pjesëmarrjet e tij në investime në aksione në shoqërinë bijë në Kosovë, nëpërmjet shtesave kapitale.

Të gjitha shoqëritë e Grupit Eurosig gëzojnë parametrat e gjendjes financiare për vitin 2020 në përputhje të plotë me kërkesat ligjore në fuqi.

Treguesit kryesorë për vitin 2020

Nr.	Emërtimi	Volumi i primeve të shkruara bruto	Pesha specifike ndaj totalit	Dëme të paguara
1	Eurosig - Shqipëri	2,035,701,962 Lekë	45.21%	574,900,595 Lekë
2	Eurosig - Kosovë	9,712,655 Euro	26.68%	4,898,120 Euro
3	Insig - Shqipëri	1,065,923,682 Lekë	23.67%	273,796,498 Lekë
4	Insig-Jetë - Shqipëri	199,816,141 Lekë	4.44%	55,099,496 Lekë
	Totali	4,502,605,838 Lekë	100%	1,509,547,133 Lekë

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Ndër vite Grupi Eurosig ka një vëmendje të shtuar ndaj përgjegjësisë sociale. Falë angazhimit dhe kujdesit të vazhdueshëm të Presidentit, z. Kadri Morinaj, Eurosig ka angazhuar burime njerëzore dhe financiare, të cilat janë në dispozicion të drejtpërdrejt të shoqërisë dhe mjedisit ku Eurosig ushtron veprimtarinë e saj, por dhe më gjerë, mjedisit kulturor, artistik, mediatik etj. Një vëmendje të veçantë Grupi Eurosig dhe Presidenti Morinaj ka edhe ndaj shtresave në nevojë.

Veprimi në kuadër të përgjegjësisë sociale u shfaq dukshëm gjatë periudhës së parë të pandemisë së koronavirusit, ku evidentojmë:

● Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Asamblesë së Aksionarëve dhe Këshillit Mbikëqyrës të Grupit Eurosig&Insig dhe UBA Bank (mars 2020), me moton e të madhit Pjetër Bogdani “Fati i popullit tim është fati im”, u vendos:

● Referuar traditës së Grupit, por edhe situatës së rënduar, për të qenë në krah të heronjve të heshtur, stafit mjekësor, për të ruajtur qëndrueshmërinë dhe në krah të politikave të qeverisë, u dhuruan 30 000 euro për Qeverinë Shqiptare në shërbim të stafit mjekësor të infektivit në Tiranë e në rrethe. Gjithashtu u dhuruan dhe 20 000 euro për Bashkinë e Tiranës, që t’u vijë në ndihmë familjeve në nevojë e të moshës së tretë.

● Përveç mundësimit të vijimit të punës së stafit nga banesat e tyre, me qëllim vazhdimin e shërbimit, Grupi Eurosig t’u ofrojë klientëve shërbimet online dhe t’u përgjigjet në kohë për të gjitha sigurimet që kërkonin në këto ditë të vështira.

● Të garantojmë klientët se do ju gjendemi pranë në çdo kohë për nevojat e tyre, duke ju ofruar edhe bonuse të ndryshme, si dhe shërbimin në shtëpi.



**NDIHMA USHQIMORE PËR
FAMILJET NË NEVOJË NGA:**





● Grupi Eurosiga&Insiga dhe UBA Bank ndërmori një fushatë unike duke u shpërndarë 12 mijë pako me ndihma ushqimore dhe sanitare familjeve që janë në vështirësi ekonomike, në të 61 bashkitë e vendit. Gjithashtu u akorduan 10 mijë US\$ për shoqatën Vatra në New York, për t'u ardhur në ndihmë shqiptarëve në vështirësi ekonomike në SHBA.

● Grupi Eurosiga&Insiga dhe UBA Bank, në bashkëpunim me Fondacionin "Nermin Vlora Falaschi", mundësuan pako me ushqime dhe produkte sanitare për ikonat e ekranit shqiptar ndër vite: Tinka Kurti, Margarita Xhepa, Reshat Arbana, Mehdi Malkaj, Irini Qirjako, Silvana Braçe, Myfarete Laze, Elsa Xhai, Laura Kule, Qamile Paja, Edlira Haxhiymeri, Lavdie Bifsha, Fadile Skëndaj, Vojsava Rama, Xhemaile Allushi dhe Eva Ruxhi.

● Grupi Eurosiga&Insiga dhe UBA Bank u kanë ardhur në ndihmë edhe Shoqatës Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë, duke dhuruar pako me ndihma ushqimore për jetimët dhe të afërmit e tyre.



Gjithashtu, nga veprimtaritë e mbështetura financiarisht për vitin 2020 nga Grupi Eurosig-INSIG&UBA Bank dhe Presidenti i Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, veçojmë:

● Mbrëmjen gala "Oda", mbajtur në Pallatin e Brigadave me pjesëmarrës të shumtë, pasi, përveç turizmit, një vëmendje të madhe mori edhe tragjedia e tërmetit të 26 nëntorit dhe solidarizimi me familjet e prekura (janar 2020).

● Edicionin e dytë të Safety&Security Expo 2020, organizuar në Tiranë nga Expocity Albania me temë: "Ju presim edhe gjatë ditës së sotme të na vizitoni për t'u informuar mbi sigurimet" (shkurt 2020).

● Panairin e Shkencës dhe Inxhinierisë, ku u paraqitën mbi 700 punime nga gjimnazistë dhe nxënës nga e gjithë Shqipëria dhe u vlerësuan projektet më të mira (shkurt 2020).

● Udhëtimin dy ditor Kulla e Artë - Razem me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

● Grupi Eurosig&Insig, UBA Bank dhe Bashkia Gramsh u kthyen shpresën familjes Toçi, me pesë fëmijë jetimë, e cila ishte në vështirësi ekonomike, duke u ndërtuar dhe mobiluar shtëpinë prej 150 m2 në rrethin e Gramshit. Me rastin e festës së Kurban Bajramit, Presidenti i Grupit Eurosig, Zoti Kadri Morinaj, u dhuroi edhe një milion lekë pesë fëmijëve të mrekullueshëm të kësaj familjeje me urimin që të rriten të lumtur dhe të marrin drejtimin e duhur në jetë dhe shoqëri (korrik 2020).

● Festivalin e organizuar për 4 netë radhazi nga gjigandi i muzikës, Gjergj Leka, me titull "Festa e Këngës Shqiptare". Me mbështet-

jen e Grupit Eurosig&Insig u mbledhën ikonat e muzikës shqiptare nga e gjithë bota, një event ku këngëtarë të të gjitha moshave sollën perlat e muzikës ndër vite. Gjithnjë jemi në mbështetje të artit dhe vlerave kombëtare (shtator 2020).

● Mbështetja e Federatës Shqiptare të Çiklizmit në Turin e 77-të të Shqipërisë. Me gjithë pengesat për shkak të pandemisë, çiklistë nga Shqipëria, Italia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi vendosën të sfidojnë Covid-19 dhe iu bashkuan nismës së Federatës në Xhiron e 77-të çiklistike (shtator 2020).

● Edicionin e 15-të Festivalit të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Akademinë e Filmit dhe Multimedias Marubi, i cili përfundoi me sukses në shtator 2020 me filmin austriak KAVIAR. Për disa vite radhazi, Grupi më i madh i Sigurimeve Eurosig&Insig mbështet veprimtaritë e kësaj Akademie.

● Falë mbështetjes financiare nga Presidenti i Grupit Eurosig&Insig, Z. Kadri Morinaj, historia e “Vatrës” do të rikthehet në një botim dokumentash, të mbledhura nga arkivat brenda dhe jashtë vendit. Akademiku Beqir Meta do të sjellë për lexuesin një kolanë dokumentash prej 5 volumesh me historinë e Vatrës nga themelimi e deri në ditët e sotme.

● Organizimin e Kuvendit të 3-të Ndërkombëtar të Akademisë së Shkencave “Rrënjët tona”, me rastin e 125 vjetorit të Kongresit të Korilianos (Kalabri) dhe 112 vjetorit të Kongresit të Manastirit (dhjetor 2020).

● Me privilegjin për të qenë pranë talenteve të shahut, Grupi Eurosig&Insig dhe UBA Bank mundësoi takimin e përvitshëm të





shahistëve të vegjël me rastin e Festave të Fundvitit, duke u shpërndarë atyre dhe dhurata. Nga pjesëmarrësit, tre janë kampionë kombëtar; një nga vajzat është renditur e 5-ta në Ballkan dhe e 15-ta në Botë. Falë këtyre talenteve, shahu në Shqipëri ka një të ardhme të ndritur.

Veprimtari të tjera:



● Grupi Eurosig&Insig zhvilloi një trajnim mbi zhvillimin dhe zgjerimin e shërbimeve për Sigurimet e Përgjegjësisë. Kualifikimi i mëtejshëm i stafit dhe zgjerimi i gamës së Sigurimeve të Përgjegjësisë do t'u vijë në ndihmë klientëve e bizneseve për të plotësuar nevojat e tyre pranë shoqërive Eurosig dhe Insig.



● Grupi Eurosig&Insig zhvilloi një trajnim në bashkëpunim me Barleti Training and Testing Center mbi "Teknika dhe Strategji të suksesshme të negocimit në takime dhe në shitje". Kualifikimet e mëtejshme të punonjësve të shitjes vihen në funksion të klientit, për t'u qëndruar sa më pranë dhe me një shërbim të standardeve Europiane.



● Grupi Eurosig&Insig, në bashkëpunim me Swiss Contact dhe projektin Aftësi për Punë, zhvilluan një trajnim mbi funksionimin e tregut të sigurimeve me nxënës të Shkollës Teknike Ekonomike të Tiranës. Ata u njohën me avantazhet dhe sfidat që kjo industri ofron. Nxënësit u përshëndetën edhe nga Presidenti i Grupit Eurosig&Insig, z. Kadri Morinaj, i cili u dha atyre disa këshilla sociale dhe profesionale. Për disa javë radhazi, kjo shkollë pati dyert e hapura pranë shoqërive Eurosig dhe Insig.

PROMOVIMI I VLERAVE TË EUROSIG, ÇMIME, VLERËSIME

● Në sondazhin online të www.kohajone.com, ndonëse kishte emra të fortë të biznesit si konkurrentë, falë bamirësisë dhe shpirtit të tij fisnik Presidenti i Grupit Eurosig&Insig, Z. Kadri Morinaj, u shpall "Biznesmeni i Vitit 2020".

● Presidentit të Grupit Eurosig&Insig, Z. Kadri Morinaj, Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë i akordoi Certifikatë Mirënjohje me motivacionin "Për ndihmën e vazhdueshme ndaj personave në nevojë dhe jetimëve të Shqipërisë". Kjo shtresë, shpesh pa mbështetje, ka patur përherë vemendjen e Grupit Eurosig&Insig.

● Eurosig është renditur nga SeeNews në vendin e 78-të mes qindra kompanive të sigurimit. SEE TOP 100 është rankimi i siguresve më të mëdhenj në Europën Lindore. Burimi i të dhënave mbi kompanitë e sigurimit janë bankat qendrore, regjistrat kombëtarë, autoritetet financiare, qeveritë, korporatat dhe vetë kompanitë.



PJESËMARRJET E EUROSIG NË KAPITALIN E SHOQËRIVE TË TJERA

Eurosig zotëron 100% të kapitalit të shoqërive të sigurimeve INSIG Jo-jeta dhe INSIG Jeta, në Shqipëri, dhe Eurosig, në Kosovë. Gjatë vitit 2020, Eurosig rriti pjesëmarrjen e aksioneve pranë bankës UBA në 21%.

Gjithashtu, aksionarët e Eurosig janë pjesëmarrës në kapitalin e shoqërive të tjera, si më poshtë:

Aksionarët	Shoqëria	Përqindja
Kadri Morinaj	Bar Restaurant "Piazza" sh.p.k	100%
Xhevdet Morina	"Alb Univers" sh.p.k.	100%

LISTA E AKSIONARËVE TË EUROSIG ME PJESËMARRJE INFLUENCUESE TË KAPITALIT

Aksionar influencues për vitin 2020	Përqindja
Kadri Morinaj	64.505%

LISTA E ADMINISTRATORËVE TË EUROSIG

Administrator (Drejtor i Përgjithshëm) i Eurosig është z. Xhevdet KOPANI, i cili nuk është pjesëmarrës në kapitalin e shoqërisë.

RAPORTI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Auditimi i brendshëm për vitin 2020 është zhvilluar në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm, si dhe në zbatim të përcaktimeve në Ligjin nr. 52/2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", në rregulloren e AMF nr. 153, datë 23. 12. 2014, "Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit", në rregulloren nr. 7, datë 30. 01. 2015, "Për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në shoqërinë Eurosig" dhe "Planin e Auditimit të Brendshëm për vitin 2020 në Eurosig".

Gjatë vitit 2020, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka kontrolluar dhe audituar ecurinë e punës në fushat kryesore të veprimtarisë së Eurosig. Pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin e Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm 2020, u shqyrtua dhe miratua dhe nga Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr.04, datë 14. 05. 2021. Raporti u është shpërndarë për njohje dhe zbatim të rekomandimeve të gjitha strukturave të Eurosig.

Gjetje të Auditimit të Brendshëm

Departamenti i Sigurimeve

Gjatë vitit 2020, Eurosig shënoi rënie të shitjeve rreth 12%, nuk është arritur objektivi i rishikuar (si rezultat i pandemisë) për mbajtjen e shitjeve në të njëjtin nivel me vitin 2019 ose maksimumi i rënies të jetë 5%. Raporti sigurime të detyrueshme/sigurime vullnetare është 81% me 19%, kundrejt objektivit të vendosur 70% me 30%.

Produktet motorike. Në vitin 2020 sigurimet motorike rezultojnë me ulje primi rreth 8% krahasuar me vitin 2019. Ky portofol rezulton me rënie për shkak të rënies së nivelit të primeve të produktit Karton Jeshil dhe Kufitare, si rezultat i mbylljes së kufijve për shkak të situatës së pandemisë. Rënia e këtyre produkteve është zburur nga rritja e produktit TPL, i cili ka dhe peshën më të madhe në grupin e këtyre produkteve.

Produktet vullnetare. Pavarësisht objektivit të kompanisë për zgjerimin e tregut të produkteve vullnetare, gjatë vitit 2020 rezulton se niveli i primeve të këtyre produkteve ka rënë me rreth 26%. Përveç produktit të përgjegjësisë, të gjithë produktet vullnetare rezultojnë me rënie. Rënia e këtyre produkteve ka ardhur si rezultat i ndikimit të pandemisë në ekonominë e vendit, në mbylljen e kufijve etj. Faktorë të tjerë që kanë ndikuar janë dhe shtyrja e tenderave publik me prime të konsiderueshme, bashkëpunimi i ulët me bankat, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për përmirësimin e bashkëpunimit etj. Është bërë analizë e plotë

ekonomike e situatës, me qëllim që të identifikohen faktorët që kanë ndikuar dhe të rishikohen mundësitë e zgjerimit të këtij tregu duke përdorur teknika e strategji të reja.

Nëse i referohemi realizimit të objektivave sipas degëve rezulton se, pavarësisht situatës së vështirë të krijuar gjatë 2020-ës, degët e Tiranës, Elbasanit, Lezhës etj. kanë arritur që të realizojnë objektivat e vendosura dhe t'i tejkalojnë ato. Ndikimin më të madh negativ në rezultatin e përgjithshëm të shoqërisë e ka dhënë rënia e shitjeve të strukturave qendrore, të cilat zënë dhe peshën më të madhe ndaj shitjeve totale. Pavarësisht performancës së mirë të disa degëve, objektivi i vendosur lidhur me produktet vullnetare nuk është realizuar pothuajse në asnjë degë.

Gjatë vitit 2020 është konstatuar rritja e shpenzimeve të marrjes në sigurim (komisione dhe bonuse) krahasuar me vitin e mëparshëm. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit të komisioneve të aplikuara, me qëllim ruajtjen e nivelit të shitjeve, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, por dhe për shkak të konkurrencës së lartë në treg. Rritja e nivelit të shpenzimeve është më e lartë se norma e rritjes së shitjeve, ndaj ky është një tregues që duhet mbajtur në konsideratë me qëllim që shpenzimet e marrjes në sigurim të mbahen në nivelin e duhur dhe të jenë efektive.

Është rritur kontrolli i ushtruar nga strukturat e marrjes në sigurim në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Administrimit të Shitjeve, për rrjedhojë ka pasur një përmirësim të dukshëm lidhur me zbatimin e procedurave të marrjes në sigurim. Ka pasur një përmirësim të dukshëm në kushtet e kontratave të sigurimit dhe përgjithësisht është vlerësuar saktë risku i klientëve dhe përcaktimi i primeve është bërë në përputhje me riskun. Janë organizuar trajnime, si dhe është rritur bashkëpunimi me strukturat vendore në funksion të identifikimit të mundësive të zgjerimit të tregut. Të dhënat e shitjeve janë pasqyruar saktë në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe janë kryer rakordimet përkatëse çdo muaj ndërmjet strukturave të brendshme (Drejtorisë së Administrimit të Shitjeve dhe Departamentit Ekonomik). Raportimi në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare është kryer konform udhëzimeve.

Linja të tjera biznesi të shoqërisë

Gjatë vitit 2020 janë hartuar dhe miratuar një sërë aktesh të brendshme me qëllim që të arrihet përputhshmëria e plotë me bazën ligjore, janë bërë përmirësime në Sistemin e Brendshëm informatik në funksion të përshtatjes së tij me kërkesat e palëve të treta dhe strukturave të kompanisë, si dhe ofrimit të një shërbimi më të mirë për klientët. Në sistemin e brendshëm të kompanisë janë të implementuar moduli i shitjeve, moduli i dëmeve dhe moduli financiar. Moduli i shitjeve është i integruar me modulin financiar dhe të dhënat e shitjeve transferohen automatikisht, si dhe është bërë i mundur raportimi online i dëmeve në



AMF në kohë reale, nëpërmjet sistemit të brendshëm. Integrimi i moduleve në sistemin e brendshëm ka ndikuar në përmirësimin e procedurës së marrjes në sigurim, në uljen e riskut të mashtrimit dhe gabimit njerëzor, si rezultat i transferimit automatik të të dhënave nga një modul në tjetrin. Me vënien në funksion të plotë të sistemit arrihet që të sigurohet informacion i plotë i klientëve dhe në këtë mënyrë vlerësohet saktë risku i tyre gjatë procedurës së marrjes në sigurim, i gjithë informacioni i nevojshëm gjenerohet në kohë, si dhe është rritur niveli i sigurtisë së ruajtjes të të dhënave.

Strukturat e Trajtimit të Dëmeve funksionojnë mbi bazën e organizimit të bërë nga Drejtoria e Përgjithshme, të ndarë sipas produkteve motorike dhe vullnetare dhe llojit të dëmeve shëndetësore/motorike për produktet motorike. Gjatë vitit 2020 është arritur që, sipas udhëzimeve nga Drejtoria e Përgjithshme, të trajtohen e të dëmshpërblehen klientët brenda afateve të përcaktuara. Janë trajtuar me prioritet rastet e klientëve, të cilët nuk kanë qenë dakord me dëmshpërblimet, të cilat janë diskutuar në komisionet e posaçme me qëllim që t'u shërbehet sa më mirë klientëve dhe të kryhet vlerësim sa më i drejtë. Është krijuar një standard lidhur me trajtimin e praktikave, duke dokumentuar gjithë procedurën e trajtimit jo vetëm fizikisht, por dhe në sistemin e brendshëm për praktikën e dëmeve motorike, gjë që ka ndikuar në përmirësimin e punës, ruajtjen e informacionit dhe gjenerimin e tij në kohë reale.

Drejtoria Juridike është angazhuar në ndjekjen e proceseve gjyqësore të shoqërisë Eurosig, si dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore të rasteve të Fondit të

Kompensimit për llogari të BSHS. Nga ana e juristëve janë ndjekur të gjitha proceset gjyqësore të shoqërisë dhe përgjithësisht janë angazhuar dhe ekspertë të fushave përkatëse (mjek, vlerësuesi i dëmeve etj.) me qëllim mbrojtjen sa më të mirë të interesave të shoqërisë. Përgjithësisht, rezultatet e gjyqeve kanë qenë në favor të kompanisë, gjë që tregon punën e kujdesshme të bërë dhe nga punonjësit e trajtimit të dëmeve.

Statistika. Të dhënat lidhur me shitjet, anulimet, kthimet, dëmtimet e policaeve janë të pasqyruara saktë në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Të dhënat lidhur me praktikën e dëmeve janë pasqyruar saktë në database-in e dëmeve, si dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Janë respektuar afatet e dërgimit të evidencave ndërmjet strukturave, si dhe afatet e dërgimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Mbrojtja nga Risku. Shoqëria Eurosig sh.a. gjatë vitit 2020 ka hartuar “Strategjinë për Menaxhimin e Riskut”, në të cilën janë përcaktuar sistemi, politika dhe parimet e menaxhimit të riskut. Në këtë strategji është përcaktuar në mënyrë të plotë procesi i menaxhimit të riskut, përgjegjësitë dhe detyrat e strukturave të kompanisë për identifikimin dhe menaxhimin e risqeve.

Në vitin 2020 u hartua dhe materiali i “Analizës së ndikimit të pandemisë Covid 19”, ku përcaktohet ndikimi i pandemisë në kompaninë Eurosig, si dhe masat e marra për zbutjen e efekteve negative të pandemisë. Në momentin e identifikimit të riskut të krijuar si rezultat i pandemisë, menaxhimi i lartë i kompanisë nxori disa akte të brendshme për reduktimin e shpenzimeve administrative, të cilat patën impakt pozitiv në zbutjen e nivelit të riskut, si dhe hartoi “Planin e vijimësisë së veprimtarisë së Eurosig për përballimin e pandemisë dhe krizave të tjera”.

Në përgjithësi ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm brenda departamenteve dhe njësive të audituara, si në drejtim të hartimit të procedurave, menaxhimit të shpenzimeve dhe administrimit të dokumentacionit. Janë kryer investigime, verifikime, vlerësime dhe kontrole paraprake të dokumentacionit justifikues. Ky sistem me procedurat dhe verifikimet përkatëse ka ndikuar në identifikimin, kontrollin dhe administrimin e risqeve që mbulojnë dhe menaxhojnë departamentet dhe njësitë e audituara.

Për periudhën në vazhdim, Njësia e Auditimit të Brendshëm do të kontrollojë dhe ndjekë rekomandimet e lëna në auditimet e kryera, si dhe njëkohësisht do të fokusohet me auditimin e veprimtarisë për vitin 2021. Për çdo pasaktësi, moszbatim apo shkelje të konstatuara në zbatimin e përcaktimeve në aktet ligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të Eurosig do të raportohet informacion i detajuar dhe do të jepen rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e punës në vazhdim.

MONITORIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I RISKUT QË NDËRMERR EUROSIG

Në Eurosrig është implementuar një sistem i plotë i menaxhimit të riskut i shpërndarë në të gjitha nivelet e shoqërisë, në mënyrë që të mbështesin realizimin e objektivave strategjike dhe specifike. Për rregullimin dhe normimin e punës së strukturave të Eurosrig, në tërësi, si dhe në drejtim të pranimi dhe menaxhimit të riskut, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm kanë nxjerë një sërë aktesh të brendshme, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 52, datë 22. 05. 2015, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet rregullatore në zbatim të tij.

Duke marrë në konsideratë madhësinë e veprimtarisë së shoqërisë, kompleksitetin e saj dhe profilin e riskut, Eurosrig ka krijuar Departamentin për Menaxhimin e Riskut, punonjësit e të cilit janë të trajnuar dhe zotërojnë kapacitetet e duhura profesionale për menaxhimin e riskut në shoqërinë e sigurimit.

Eurosrig aplikon metodologji dhe praktika bashkëkohore për identifikimin, klasifikimin (kategorizimin), vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve, në koherencë me kërkesat e AMF-së, të përcaktuara në Manualin nr. 132, datë 31. 10. 2014, “Mbikëqyrja me fokus riskun”.

Departamenti për Menaxhimin e Riskut, në koordinim me strukturat qendrore dhe vendore të Eurosrig, çdo vit identifikojnë risqet ndaj të cilëve është e ekspozuar veprimtaria e Eurosrig dhe që përbëjnë kërcënim për realizimin e objektivave strategjike dhe specifike të shoqërisë.

Procesi vjetor i Menaxhimit të Riskut në Eurosrig finalizohet me Raportin e Vetëvlerësimit të Riskut dhe Aftësisë Paguese dhe Raportin Vjetor mbi Vlerësimin e Risqeve në Eurosrig, i cili dërgohet në AMF.



TREGUESIT E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT, LIKUIDITETIT DHE AKTIVEVE NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE

Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë dhe kapitali shtesë (kapitalet e veta sipas pasivit të bilancit të certifikuar).	2,713,420,085
II	Elementët e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, sipas nenit 79 të Ligjit nr. 52/2014, i ndryshuar.	806,491,754
III	Kapitali (Aftësia paguese): (A-B).	1,906,928,330
IV	Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit nr. 52/2014.	364,486,302
V	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit nr. 52/2014.	370,000,000
VI	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2, neni 80, të Ligjit nr. 52/2014.	546,729,454
VII	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (C-F).	1,360,198,876
VIII	Mjaftueshmëria e kapitalit.	I MJAFTUESHËM

Treguesi i Likuiditetit

Treguesi i Raportit të Likuiditetit raportohet periodikisht në AMF, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullatore. Shoqëria Eurosig është likuide dhe zotëron normë shumë të mirë likuiditeti pasi rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar nenit 6, pika 1, të Rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit”, rezulton më i lartë ose i barabartë me 1.

Treguesi i Aktiveve në Mbulim të Provigjoneve Teknike (PT), më 31. 12. 2020.

Nr.	Emërtimi	Vlera e lejuar në mbulim të PT (në lekë)
I	Aktivet e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14.	4,161,783,697
II	Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit.	-
III	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, datë 28.04.2015, neni 4.	1,025,544,498
IV	Totali i Investimeve (I+II+III).	5,187,328,195
V	Totali i Investimeve të Lejuara (Totali i “Vlera në fakt” zbritur “Investime mbi limitet e lejuara”).	4,921,205,174
VI	Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5).	2,442,064,589
VII	Tepicë (+) /Mungesë (-) (V-VI).	2,479,140,585
VIII	Mbulimi në % (V/VI).	MBI KËRKESAT LIGJORE

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021

Objektivat strategjike:

- 1) Rritja me 10%, krahasuar me vitin 2020, e volumit të primeve të shkruara bruto, duke garantuar rritje të kapitalit financiar, të performancës ekonomike, të aftësisë paguese, të rezervave, si dhe përsosur sistemin e kontrollit të brendshëm dhe sistemin e menaxhimit të riskut.
- 2) Në fundin e vitit 2021, raporti i volumit të primeve të shkruara bruto në sigurimin vullnetar me volumin e primeve të shkruara bruto në sigurimin e detyrueshëm të jetë në masën 23% me 77%.
- 3) Shpenzimet për vitin 2021 të mbahen në nivelin 96% të të ardhurave.
- 4) Rritja e volumit të dëmeve të paguara duke synuar vlerësim të drejtë, pagesë të shpejtë, si dhe rritje deri në 28% të raportit të volumit të dëmeve të paguara me volumin e primeve të shkruara bruto, deri në fund të vitit 2021.¹
- 5) Zhvillimi i site paralel që do të përdoret për menaxhimin e shoqërisë në rastin e katastrofave natyrore; hartimi, miratimi dhe testimi i Planit të Vazhdueshmërisë së Biznesit në raste katastrofash.
- 6) Hartimi dhe miratimi i strategjisë së shoqërisë Eurosig sh.a. për periudhën 2022 – 2026.

Objektivat specifike:

- 1) Segmentimi i klientëve, duke u përqendruar fort tek produktet vullnetare, nëpërmjet burimeve njerëzore me formimin e duhur profesional, kombinuar me një marketing bindës.
- 2) Zbatimi rigorozi i politikave dhe procedurave standarde për marrjen në sigurim dhe risigurimin, me bazë riskun.
- 3) Zbatimi i politikave për uljen e produkteve me humbje teknike.
- 4) Rishikimi dhe përmirësimi i kushteve të sigurimit të pronës dhe përgjegjësisë, duke konsideruar problematikat e identifikuara nga ngjarjet e tërmeteve të vitit 2019.

³ Në vlerën e këtij raporti nuk është përfshirë vlera e dëmeve që do paguheshin për Fondin e Kompensimit.

- 5) Rinegociimi i marrëveshjeve me të gjitha bankat në lidhje me kushtet e bashkëpunimit.
- 6) Rishikimi i termave të marrëveshjeve të sigurimit, në lidhje me mjaftueshmërinë e mbulimit, duke reflektuar çështjet e identifikuar nga trajtimi i dëmeve të tërmeteve të vitit 2019.
- 7) Shfrytëzimi i të gjitha kapaciteteve të programit informatik e-Insure nga strukturat qendrore dhe vendore të Eurosig.
- 8) Fuqizimi i kapaciteteve të Teknologjisë së Informacionit të Eurosig nëpërmes: zgjerimit të rrjetit të brendshëm, përmirësimit të sistemit të virtualizimit, përmirësimit të administrimit të informacionit dhe raporteve në sistemin e-Insure, përmirësimit të infrastrukturës elektrike dhe informatike në Drejtorinë e Përgjithshme, përmirësimit të infrastrukturës së mbrojtjes nga sulmet kibernetike (Firewall), implimentimit të projektit "Shërbim Klienti", vijimit të procesit të licencimeve dhe upgrade-imeve të pajisjeve informatike dhe rrjetit, trajnimeve periodike të stafit të IT-së.
- 9) Vlerësimi i drejtë, i shpejtë dhe pagesa e dëmit brenda afateve të përcaktuara në aktet rregullatore dhe aktet e brendshme të Eurosig.
- 10) Përditësimi i njohurive mbi legjislacionin dhe teknologjinë bashkëkohore në përdorim, me qëllim të trajtimit të saktë e në kohën e duhur, sipas kushteve të kontratave, të dosjeve të dëmeve sipas produkteve.
- 11) Kryerja e sondazheve, kontrollove dhe analizave periodike mbi performancën e punonjësve dhe ecurinë e trajtimit të dosjeve të dëmit, pagesave, sipas kushteve të kontratave, funksionimit dhe efikasitetit të shfrytëzimit të kapaciteteve të programit e-Insure me qëllim të menaxhimit sa më efikas të procesit në tërësi.
- 12) Ndjekja e një politike konservative të shpenzimeve në tërësi, veçanërisht të shpenzimeve të përgjithshme.
- 13) Mbajtja e një gjendjeje të shëndoshë financiare, duke siguruar një aftësi paguese të qëndrueshme, si dhe aktive të mjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike.
- 14) Forcimi i auditimit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm.
- 15) Trajnimi i burimeve njerëzore, i kombinuar me trajnime të nivelit të mesëm operacional edhe jashtë Shqipërisë. Përparësi do të ketë trajnimi i punonjësve të strukturave të Marrjes në Sigurim dhe Trajtimit të Dëmeve.
- 16) Trajnimi i burimeve njerëzore në fushën e intervistimit të klientëve dhe investigimit të rasteve të dyshimta, me qëllim zbulimin e rasteve të mashtrimit.

OPINIONI I SHOQËRISË AUDITUESE DHE PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF

Eurosig sh.a

**Pasqyrat Financiare të Konsoliduara , më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Së bashku me raportin e audituesit të pavarur**

Përmbajtja	Faqja
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iv
Pasqyra e riparaqitur e Konsoliduar e Pozicionit Financiar	5
Pasqyra e riparaqitur e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e riparaqitur e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital	7
Pasqyra e riparaqitur e Konsoliduar e Flukseve të Parasë	8
Shënimet për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara	9-69

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionarët e Shoqërisë Eurosig sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara ("Pasqyrat financiare") të Grupit **EUROSIG sh.a.** (Grupi) të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në bazat për opinion me rezervë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin me rezervë

Më poshtë paraqiten modifikimet e opinionit në lidhje me pasqyrat financiare individuale që kanë efekt në pasqyrat e konsoliduara.

Eurosig sh.a shoqëria mëmë

Pasqyra individuale e pozicionit financiar të Shoqërisë përmban llogari të arkëtueshme nga rrjeti i shitjes në vlerë neto prej 311,907 mijë lekë (2019: 316,312 mijë Lek) të cilat janë kryesisht paradhënie ndaj punonjësve që shërbejnë si agjent (shënimi 13). Këto parapagime nuk i janë kthyer Shoqërisë deri në datën e këtij raporti. Megjithatë ekzistonin të dhëna objektive zhvlerësimi për këto teprica në datën e raportimit, Shoqëria nuk ka kryer çmuarje për zhvlerësim sipas kërkesave të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 39 "Instrumentat Financiarë, Njohja dhe Matja". Rrjedhimisht, ne nuk mund të përcaktojmë nëse do të kishte nevojë për rregullime nga zhvlerësimi i këtyre kërkesave të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020.

Pasqyra individuale krahasuese e pozicionit financiar përmban aktive të tjera të cilat përfshijnë kërkesa të arkëtueshme për shitjen e Insig Jetë sh.a në vlerën prej 453,306 mijë lekë me 31 dhjetor 2019. Siç paraqitet në shënimin 13 të këtyre pasqyrave financiare, më 26 maj 2020 është firmosur marrëveshja për revokimin e kontratës së shitjes së aksioneve të Insig Jetes date 10.05.2017.

Në bazë të marrëveshjes së revokimit, Eurosig sha ka kthyer shumën prej 20,000 mije Lek palës blerëse dhe ka marrë në këmbim 90% të aksioneve për vlerën 333,000 mijë Lek. Për rrjedhojë, fitimet e realizuara në vitin 2017 nga shitja e kuotave për shumën 140,305 mijë lek kanë zvogeluar vlerën e këtyre kërkesave për arkëtim dhe kane renduar rezultatin e vitit 2020. Si efekt i kësaj ngjarje, llogaritë e arkëtueshme për shitjen e Insig Jeta janë të mbivlerësuar për shumën 140,305 mijë Lek me 31 dhjetor 2019, dhe fitimet për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 janë nënvlersuar për të njejten shumë.

Insig sh.a

Pasqyra individuale e pozicionit financiar të Shoqërisë Insig sh.a përmban në zërin e aktiveve afatgjata materiale ndërtesa në vlerën 929,649 mijë lekë.

Shoqëria ka zgjedhur metodën e rivlerësimit për të matur vlerën e ndërtesave. Gjatë vitit 2020 shoqëria ka kryer dhe regjistruar rivlerësimin për disa prej ndërtesave që ka në zotërim dhe ka rezultuar në plus vlerë nga rivlerësimi në vlerën 241,301 mijë lekë.

Kjo mënyrë rivlerësimi nuk është në përputhje me SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale i cili kërkon që nëse një aktiv afatgjatë rivlerësohet, duhet të rivlerësohet e gjithë kategoria e aktiveve afatgjata materiale të cilës ai i perket. Si rrjedhojë, ne nuk jemi në gjendje të gjykojmë mbi vlerën e aktiveve afatgjata materiale paraqitur në keto pasqyra financiare dhe efektin që do të kishte nëse e gjithë klasa do të rivlerësohej.

Pasqyra individuale e pozicionit financiar të Shoqërisë Insig Sh.a përmban llogari të arkëtueshme nga rrjeti i shitjes në vlerë neto prej 77,490 mijë lekë (31 dhjetor 2019: 102,337 mijë Lek) të cilat janë kryesisht paradhënie ndaj punonjësve që shërbejnë si agent (shënimi 13). Këto paradhënie nuk i janë kthyer Shoqërisë deri në datën e këtij raporti. Megjithatë ekzistojnë të dhëna objektive zhvlerësimi për këto teprica në datën e raportimit, Shoqëria nuk kreu çmuarje për zhvlerësim sipas kërkesave të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 39 "Instrumentat Financiarë, Njohja dhe Matja". Rrjedhimisht, ne nuk mund të përcaktojmë nëse do të kishte nevojë për rregullime nga zhvlerësimi i këtyre kërkesave të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020.

Pasqyra individuale krahasuese e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 përmban fonde të transferuara për shtesën e kapitalit të Degës Insig Kosova, detyrime si pasojë e këtyre marrëdhënieve, humbjet e mbartuara deri në 31 mars 2019 si dhe efektet e kursit të këmbimit nga përkthimi. Sikurse përshkruhet në shënimin nr 2.3, Banka Qendrore e Kosovës në datë 26 prill 2019 ka revokuar licencën e Insig Kosova dhe ka njoftuar hapjen e procedurave të likuidimit të detyrueshëm dhe ka caktuar një likuidator. Për sa më sipër shoqëria ka bërë dekonsolidimin e shoqërsisë Insig sh.a Dega Kosovë në vitin 2020, duke mbyllur të gjitha marrëdhëniet me degën dhe mbartur humbjen neto të ish-degës në vlerën 1,323,340 lekë. Në pasqyrat financiare krahasuese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 shoqëria nuk ka kryer kombinimin e Degës Insig Kosova për secilën kategori të aktiveve dhe detyrimeve si dhe kombinimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të saj.

Eurosig Kosovë sha

Siç shpjegohet në shënimin 10 të pasqyrave financiare të konsoliduara, Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi të Shoqërisë Eurosig Kosovë sha më 31 dhjetor 2020 janë në vlerë 239,682 mijë lekë. Ne kemi identifikuar që disa të arkëtueshme janë me vonesë për më shumë se një vit dhe për to ka indikacione objektive për provizionimin e tyre. Shoqëria nuk ka bërë vlerësim për provizionimin e të arkëtueshmeve nga sigurimet që konsiderohet si devijim nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Si rrjedhojë, ne mungesë të dëshmive të përshtatshme të auditimit për rikuperimin dhe validitetin e primeve të arkëtueshme, ne nuk ishim në gjendje për të vendosur nëse ishte i nevojshëm ndonjë ndryshim lidhur me këto shuma.

Çështje për t'u theksuar

Siç është shpalosur në shënimin 13 të këtyre pasqyrave financiare, aktive të tjera, kompania ka prezantuar parapagime për autoritetet tatimore në vlerë prej 91,290 mijë lekë, që vijnë si rezultat i rivlerësimit të detyrimeve tatimore, ndëshkimeve dhe interesave të paguar me raportin e lëshuar më 10 nëntor 2010, shoqëria Eurosig Kosovë sha ka ngritur padi ndaj Administratës Tatimore të Kosovës për të cilën nuk është nxjerrë një vendim i gjykatës. Ne si auditues nuk mund të vlerësojmë apo parashikojmë rezultatin e padisë së ushruar kundër Administratës Tatimore.

Ne tërheqim vëmendjen në shënimin 2.3 të pasqyrave financiare të konsoliduara në të cilën paraqitet informacion mbi vendimin numër 80-2019-274 datë 01.02.2019 të marrë nga Gjykata Administrative e Shkalles së parë Tirane e cila ka pranuar padinë e Shoqërisë ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për shfuqizimin e aktit administrativ, nr. 162 datë 30.07.2018 të Bordit të AMF-së dhe masat e marra sipas atij vendimi, si edhe padinë për detyrimin ndaj AMF-së për njohjen e investimit të kryer në blerjen e aksioneve në shoqëritë e kontrolluara, si aktive në mbulim të provizioneve teknike dhe aftësisë paguese. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2254 (86-2019-2581) datë 12.07.2019, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke e kthyer atë në titull ekzekutiv, të detyrueshëm për zbatim. Për pasojë, prej 3 muajve të dytë të vitit 2019 ka përfshirë në përlllogaritjet e treguesve rregullatore investimet në shoqëritë e kontrolluara, gjë e cila ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e treguesve rregullatorë. AMF ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë për këtë vendim, gjë e cila nuk ka pranuar kërkesën e Autritetit Mbikqyrës për pezullimin e Vendimit të Gjykatës së Apelit, Tiranë.

Në këtë shënim, përshkruhet edhe vlerësimi i menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave

Opinionin ynë nuk është modifikuar në lidhje me këto çështje.

Çështje të tjera

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.


mazars
 Emin Duraku Str., Binjëhet Build.,
 No.5, 1013, Tirana, Albania
 NUIK: K32123008W

30 qershor 2021

Teit Gjini
 Auditues Ligjor

Pasqyra e riparaqitur e Konsoliduar e Pozicionit Financiar

	Shënimi	31 dhjetor 2020	riparaqitur 1 janar 2020	riparaqitur 1 janar 2019
Aktivi				
Mjete monetare dhe ekuivalente	8	27,376	25,045	177,165
Depozita me afat	9	3,037,118	2,138,012	2,660,279
Aktive financiare të mbajtuara deri në maturim		-	-	227,035
Aktive financiare të mbajtuara për tregëtim		-	-	65,462
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	10	520,683	548,383	436,776
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	11	738,226	582,523	723,074
Pjesa e risiguresit në provigjionet e kontratave të sigurimit	12	598,257	868,728	376,022
Aktive të tjera	13	1,133,652	1,764,314	1,622,155
Tatim i shtyrë		314	266	-
Aktive afat-gjata materiale	14	1,594,860	1,357,980	1,477,317
Te drejta të perdorimit të aseteve	15	92,968	115,079	45,477
Parapagimi i tatimit mbi fitimin		1,247	-	-
Aktive të mbajtura për investim	16	437,969	-	-
Tituj kapitali	17	293,654	161,816	37,000
Aktive afat-gjata jomateriale dhe emri i mirë	18	11,295	30,192	767,358
Totali i aktivitet		8,487,620	7,592,339	8,615,120
Detyrime				
Provigjione për kontratat e sigurimit	19	5,440,536	5,305,993	6,547,824
Detyrime të qirasë financiare	20	117,092	109,509	64,590
Huate	21	184,945	144,186	170,342
Llogari të pagueshme për sigurimin, risigurimin dhe të tjera	22	423,634	408,138	485,842
Provigjione të tjera		33,548	48,260	96,393
Detyrime tatimore aktuale		19,383	17,366	26,719
Tatimi i shtyre		2,333	2,333	2,777
Totali i detyrimeve		6,221,471	6,035,785	7,394,487
Kapitali aksioner				
Kapitali aksioner	23	2,495,650	2,275,650	2,275,650
Rezerva të tjera	24	10,334	10,334	10,334
Rezervë rivleresimi	25	412,445	167,846	167,846
(Humbje)/ Fitimi i akumuluar	26	(797,127)	(1,024,557)	(1,174,026)
Rezerva e kursit të këmbimit	27	144,846	127,280	(59,170)
Totali i kapitalit aksioner		2,266,148	1,556,553	1,220,634
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner		8,487,620	7,592,339	8,615,121

Shënimet shpjeguese nga faqa 5 deri në 69 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara. Pasqyrat financiare të konsoliduara u miratuan nga bordi drejtues i Shoqërisë më 2021, dhe janë firmosur në emër të tij nga:

Z. Xhevdet Kopani
Drejtor i Përgjithshëm



Zj. Anila Ibro
Drejtor i Departamentit
Ekonomik

Pasqyra e riparaqitur e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Primet e shkruara bruto	28	4,420,319	4,856,265
Primet e ceduara në risigurim	28	(247,066)	(314,121)
Taksa mbi primet	28	6,792	(41,383)
Primet e shkruara neto		4,180,045	4,500,762
Ndryshimi bruto në primet e pafituara	28	(155,846)	(73,712)
Ndryshimi bruto në primet e pafituara dhe në RBNS, pjesa e risiguruesit	28	(24,780)	49,518
Primet e fituara neto		3,999,418	4,476,567
Të ardhura te tjera	29	16,296	45,441
Të ardhura financiare dhe nga investimet	30	83,103	37,328
Shpenzime financiare dhe nga investimet	30	(15,278)	(5,021)
Të ardhura neto		4,083,539	4,554,316
Dëme dhe përfitime të shlyera	31	(1,240,588)	(1,498,596)
Ndryshimi në provigjionin e dëmeve	31	(41,000)	(287,626)
Rezultati pas dëmeve dhe përfitimeve të shlyera të polic-mbajtësve, neto		(1,281,588)	(1,786,222)
Kosto të marrjes në sigurim	32	(1,340,287)	(1,413,763)
Shpenzime administrative	33	(1,041,115)	(1,150,467)
Shpenzime të tjera operative	34	(76,252)	(94,212)
Provigjion për humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme dhe të tjera		-	3,812
Te ardhura /Humbje të tjera	35	(88,373)	(27,408)
Rezultati nga shitja dhe likuidimi		-	123,750
Humbje para tatimit		255,924	209,806
Tatimi mbi fitimin	36	(28,494)	(59,614)
Fitimi I vitit		227,430	150,192
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit		262,165	186,450
Të ardhura gjithëpërfshirëse të vitit		489,595	336,642

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 69 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Eurosig sh.a.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e riparaqitur e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksioner	Rezerva e rivlerësimit	Rezerve konvertimi	Rezerva të tjera	Fitime / (humbje) e mbartur	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,275,650	302,645	(59,170)	10,334	(1,130,258)	1,399,201
Rregullime te viteve te meparshme		(134,799)			(43,769)	(178,568)
Gjendja më 1 janar 2019	2,275,650	167,846	(59,170)	10,334	(1,174,027)	1,220,633
Rezerve konvertimi			186,450			186,450
Humbja e vitit					150,192	150,192
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin						
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,275,650	167,846	127,280	10,334	(1,023,835)	1,557,275
Rregullime te viteve te meparshme					(722)	(722)
Gjendja më 1 janar 2019	2,275,650	167,846	127,280	10,334	(1,024,557)	1,556,553
Rezerve konvertimi			17,566			17,566
Rritje e kapitalit aksionar	220,000					220,000
Rritje e rezerves se rivleresimit		244,599				244,599
Rregullimi per tatimin e fitimit						
Fitim/ Humbja e vitit					227,430	227,430
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin						
Gjendja më 31 dhjetor 2020	2,495,650	412,445	144,846	10,334	(797,127)	2,266,148

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 69 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e riparaqitur Konsoliduar e Flukseve të Parasë

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	255,924	209,806
Rregullime për;		
Amortizimi i aktiveve afat-gjata	155,264	133,043
Të ardhura financiare dhe nga investimet	(34,958)	(30,533)
Fitim nga shitja/ rimarrja e Insig Jete	(68,737)	(169,007)
Rritje/ renie e pjesës së risiguruesit në provigjionet e kontratave të sigurimit	33,321	(13,438)
Efekti kursit të kembimit	(2,210)	-
Zhvleresim i llogarive të arketueshme	22,874	-
Shpenzime interesi	(6,601)	4,731
Shpenzimet e tatimit në prim	(6,745)	40,969
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues	348,132	175,571
Rënie në llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera të arketueshme	198,072	(745,309)
Rënie në koston e shtyrë të marrjes në sigurim	(129,503)	(25,414)
(Rritje) në aktive të tjera	604,633	(595,115)
Rritje/(rënie) në provigjionet e sigurimit	(232,330)	844,348
Renie në llogaritë e pagueshme për sigurimet, risigurimet dhe llogari të tjera	110,511	(47,226)
Rritje/(rënie) në qera financiare	(6,126)	13,831
Rritje/(rënie) provigjione të tjera	72,524	14,712
Detyrim për Fondin e kompesimi	-	(32,551)
Interes i paguar	25,086	(4,731)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	990,999	(401,884)
Tatimi i paguar mbi fitimin	(33,320)	(87,358)
Flukset monetare neto gjeneruar nga aktivitetet operative	957,679	(489,242)
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese		
Shtesa/pakesime të investimeve në tituj kapitali	(131,838)	331,445
Parapagime ndaj ortakut	91,503	101,772
Blerje të aktiveve afat-gjata materiale	(27,431)	(268,193)
Shitje aktiveve afat-gjate	208,044	2,040
Pakesime të aktiveve afatgjata	-	(1,872)
Renie/(rritje) në depozitat me afat	(520,649)	(540,767)
Ndryshim në aktive të mbajtura për investim	(433,267)	-
Interesa të arkëtuara	39,303	28,524
Mjete monetare neto përdorur nga aktivitetet investuese	(774,335)	(347,051)
Flukset e parasë nga aktivitetet financiare		
Rritje renie në leasing financiar	-	(8,563)
Shlyerje të qerasë financiare pjesë e IFRS 16	(59,901)	(29,715)
Ndryshim në rezervën e rivleresimit	(244,599)	-
Kapital i paguar	220,000	540,659
Shlyerje për huatë të marra	(96,764)	250,952
Flukse monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financiare	(181,264)	753,333
Rritja neto në mjetet monetare	2,080	(82,960)
Efekti i kurseve të kembimit	251	-
Mjete monetare në fillim të vitit	25,045	108,005
Mjete monetare në fund të vitit	7 27,376	25,045

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 69 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Shënimet për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

1. Informacion i Përgjithshëm

Eurosig Sh.a. ("Shoqëria"), shoqëria mëmë e Grupit, është shoqëri aksionare e themeluar në Shqipëri me vendodhje në Tiranë, rruga Papa Gjon Pali II. Eurosig Sh.a.. Shoqëria mëmë e Grupit, është subjekt i ligjit numër 52, datë 22 maj 2014, 'Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit' dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, të ndryshuar.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë mëmë të Grupit përfshin ofrimin e shërbimeve të sigurimit në aktivitetin Jo-Jetë për sigurimet motorrike, sigurimet e marinës, sigurimet e pronës, sigurimet e mallrave të transportit, sigurimet e ndërtimit, sigurimet e përgjegjëse civile dhe sigurimet e garancisë.

Shoqëria e Kontrolluar Eurosig sh.a. në Kosovë është e themeluar si Shoqëri Sigurimesh në aktivitetin e Jo – Jetës që nga i vitit 2000 fillimisht me emrin Dardania dhe duke filluar nga dhjetori i vitit 2015 doli në treg me emrin e ri Eurosig sh.a., tërësisht me kapital dhe aksionerë shqiptarë. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në bazë e në zbatim të ligjeve të aplikueshme në Kosovë dhe akteve të tjera normative të dala në zbatim të tyre, si dhe mbikëqyrjet nga Banka Qendrore e Kosovës, Departamenti për Mbikqyrjen e Sigurimeve. Eurosig sh.a., si Shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me 8 degë dhe mbi 62 zyra përfaqësimi.

Shoqëria e Kontrolluar INSIG Sh.a. është themeluar në 1991 si një shoqëri sigurimi në atë kohë 100% në pronësi të Qeverisë së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave. Aktiviteti kryesor i biznesit të saj përfshin sigurimin e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorrike, pronë, marinë dhe lloje të tjera sigurimi. Zyrat kryesore të INSIG sh.a janë Rruga "Jul Variboba", No. 21, Tiranë 1001 SHQIPERI.

Më 1 mars 2000 Insig Sh.a çeli një degë në Kosovë ("Dega"). Kjo degë ofron kryesisht sigurime të mjeteve motorrike dhe sigurim i palëve të treta në të gjithë territorin e Kosovës. Banka Qendrore e Kosovës më datë 26 prill 2019 ka revokuar licencën e Insig Dega Kosovë, ka njoftuar hapjen e procedurës së likuidimit të detyrueshëm si edhe ka caktuar një likuidator. Gjate vitit 2020 shoqëria mëmë Insig sh.a ka çkonsoliduar shoqërinë Insig sh.a Dega Kosovë.

Më 8 mars 2003, Insig Sh.a filloi të operojë edhe në territorin Republikës të Maqedonisë nëpërmjet INSIG AD, Shkup e cila pas privatizimit të Insig Sh.a, Shqipëri ndyshoi emrin në Eurosig AD, Shkup ("Shoqëri e Kontrolluar"). Eurosig AD, Shkup është 100% në pronësi të INSIG Sh.a. Në 13 mars 2019, Shoqëria e kontrolluar Insig Sh.a realizoi shitjen e 100% të aksioneve të filialit Eurosig AD, Shkup te Grazer Wechselseitige Versicherung Aktiengesellschaft Herrengasse 18-20, 8010 Graz, Austria me numer identifikimi FN 37748 me çmimin e skontuar prej 4.4 milionë euro.

Më 23 mars 2016, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, "Eurosig "sha, u shpall fitues i procedurës së privatizimit të Insig sh.a. Më 1 qershor 2016, u nënshkrua marrëveshja e blerjes dhe u morrën aprovimet e nevojshme rregullatore dhe më 2 qershor 2016 u krye transferimi i aksioneve nga Ministria e Ekonomisë të Eurosig sh.a. si dhe u bë regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").

Grupi, me anë të vendimit të Aksionareve numër 16, datë 23 dhjetor 2016 vendosi:

- 1) miratimin e ndarjes së Shoqërisë Insig sh.a në dy Shoqëri: Insig sh.a (shoqëri sigurimi jo-jete) dhe Insig Jete sh.a.
- 2) miratimin e marrëveshjes së ndarjes së Shoqërisë Insig sh.a në dy shoqëri: Insig sh.a (shoqëri sigurimi jo-jete) dhe Insig Jete.

1. Informacion i Përgjithshëm (vazhdon)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me anë të vendimit numër 202, datë 27 dhjetor 2016 miratoi e ndarjen e veprimtarisë së shoqërisë "Insig" sh.a. në shoqërinë e sigurimit "Insig" sh.a, e cila ushtron veprimtari për klasat e sigurimit të Jo-Jetes dhe në shoqërinë e sigurimit "Insig Jete" sh.a, e cila ushtron veprimtari për klasat e sigurimit të Jetës, efekte të cilat nisën prej 1 janar 2017.

Eurosig Sh.a me anë të kontratës së shitjes, datë 10 maj 2017, ka shitur 90% të aksioneve që zotëronte në Insig Jete Sh.a, respektivisht në masën 45% të aksioneve Z. Samir Mane dhe 45% të aksioneve Z. Shefqet Kastrati për vlerën totale prej 473,305 mijë Lek (3,500,000 Euro). AMF me anë të vendimit numër 53 të Bordit, datë 22 maj 2017, vendosi miratimin e pjesëmarrjes influencuese në masën 45% të aksionarit Z. Samir Mane dhe 45% të aksionarit Z. Shefqet Kastrati, në shoqërinë e sigurimit të Jetës "Insig Jete" sh.a., sipas kontratës së shitjes së aksioneve datë 10.05.2017. Më 26 maj 2020 është firmosur marrëveshja për revokimin e kontratës së shitjes së aksioneve të Insig Jete date 10.05.2017. Në bazë të marrëveshjes së revokimit, Eurosig sh.a ka kthyer shumën prej 20,000 mije Lek palës blerëse dhe mori në këmbim 90% të aksioneve për vlerën 333,000 mijë Lek. Për rrjedhojë, fitimet e realizuara në vitin 2017 nga shitja e kuotave për shumën 140,305 mijë lek kanë zvogëluar vlerën e këtyre kërkesave për arkëtim dhe rënduan rezultatin e vitit 2020. Më 31 dhjetor 2020 Grupi zotëron 100% të aksioneve të Insig Jete. Grupi operon në tregun e sigurimeve duke ofruar produkte sigurimi jo-jete dhe jete në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës.

Struktura e aksionerëve të Shoqërisë mëmë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	%	%
Z. Kadri Morina	64.51%	70.74
Shoqëria "Euro-Alba.Ea" Sh.p.k	17.66%	9.70
Z. Xhevdet Morina	17.53%	19.22
Z. Ylli Merkaj	0.30%	0.34
Totali	100.00	100.00

Asnjë nga Shoqëritë e Grupit nuk është e listuar në ndonjë bursë.

Drejtimi i Shoqërisë

Drejtimi i shoqërisë mëmë Eurosig Sh.a në Shqipëri gjatë vitit 2020 deri në datën e nënshkrimit të këtij raporti përbëhet nga:

Z.Xhevdet Kopani	Drejtor i Përgjithshëm
Zj.Anila Ibro	Drejtor i Departamentit Ekonomik
Znj. Akena Mema	Drejtor i Departamentit të Marrjes në Sigurim e Risigurim dhe Marrëdhënieve me Jashtë
Z.Agim Hysko	Zv. Drejtor i Departamentit të Dëmeve
Zj. Romeo Bace	Aktuar i Autorizuar

Bordi Mbikqyrës

Bordi mbikqyrës i Shoqërisë gjatë vitit 2020 deri në datën e nënshkrimit të këtij raporti përbëhet nga:

Z. Vasil Pilo	Kryetar
Z. Jemin Gjara	Anëtar
Z. Rexhep Mejdani	Anëtar



JEMI KUDO: NË SHQIPËRI & KOSOVË

 0800 2004

 info@eurosig.al

 eurosig.al